

AKADEMIA E SHKENCAVE – 2026
REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Lidhja nr. 1

Nr. rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷
1.	19.2.2026	Kërkesë për informacion	23.2.2026	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës tuaj, Ju informojmë se për revistat shkencore "Iliria" dhe "Candavia" mund ti gjeni në formatin elektronik <i>online</i> në faqen web të institucionit https://akad.gov.al/periodiket/ . Njëkohësisht Ju bëjmë me dije se numrat përkatës të revistave respektive, pas vitit 2023 janë ende në proces. Sa I përket revistës "Monumentet" Ju sqarojmë se kjo revistë nuk botohet nga Akademia e Shkencave.	E plotë	Nuk aplikohet
2.	29.4.2026	Kërkesë për informacion mbi publikimin e një artikulli shkencor.	29.4.2026	Përshëndetje, Duke Ju falenderuar për kërkesën tuaj, po Ju vë në dispozicion për më tej, me qëllim për t'ju ardhur në ndihmë konkrete, e-mailin e kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike, njëkohësisht kryeredaktor i revistës Albanian Journal of Natural & Technical Sciences (AJNTS).	E plotë	Nuk aplikohet

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

² Data e regjistrimit të kërkesës.

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

⁴ Data e kthimit të përgjigjes.

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

⁶ Përgjigja jepet e plotë/ e kufizuar/ e refuzuar/ e deleguar.

⁷ Kostoja monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

3.	29.4.2026	Kërkesë për informacion pwr kompletin e veprave tw Akademikut Profesor Rexhep Qosja.	29.4.2026	Përshëndetje, Duke ju falenderuar për e-mailin, ju informojmë se nuk disponojmë kompletin e veprave të Akademikut Rexhep Qosja. Në Librin Akademik, pjesë e Akademisë së Shkencave disponohet libri "Shkrimtarë dhe periudha", botim i Akademisë së Shkencave. Për detaje të mëtejshme, po ju vendosim në dispozicion nr. ee kontaktit.	E plotë	Nuk aplikohet
4.	29.4.2026	Kërkesë për informacion	2.6.2026	Përshëndetje, Duke kërkuar mirëkuptimin tuaj, lidhur me kërkesën, pas marrjes së përgjigjes nga specialistët e fushës, Ju sqarojmë se termi "endemike" ka rënë për orkidenë shqiptare. Por për një përgjigje më shteruese Ju sugjerojmë të kontaktoni me prof. A.M	E plotë	Nuk aplikohet
5.	8.6.2026	Kërkesë për informacion mbi procesin e përzgjedhjes në Akademinë e të Rinjve të Shkencës	11.6.2026	Përshëndetje, Kandidatura juaj është ende në proces shqyrtimi nga komisioni.	E pjesshme	Nuk aplikohet
6.	15.6.2026	Kërkesë për informacion/Pyetje	15.6.2026	Përshëndetje, Për pozicione konkrete, ka njoftime konkrete. Aktualisht në fushën tuaj, nuk ka njoftim për vend të lirë pune. Nëse në të ardhmen do të ketë, njoftimi specifik me të dhënat konkrete, publikohet në faqen web.Ndërkohë, libreza e punës kërkohet për njohjen e viteve të punës. Dokumentet dorëzohen pranë zyrës së protokollit ose me postë, rast pas rasti, sipas njoftimit/eve.	E plotë	Nuk aplikohet
7.	8.7.2026	Kërkesë për informacion dhe rivendosje të kontakteve me Bibliotekën e	10.7.2026	Përshëndetje, Duke Ju falenderuar për e-mailin Tuaj, po Ju vendos për më tej, të dhënat e kontaktit të X.Y, përgjegjëse e sektorit të bibliotekës:	E plotë	Nuk aplikohet

		Akademisë së Shkencave të Shqipërisë				
8.	6.7.2026	Kërkesë për informacion për “Expert Archaeologists for UK tv series”	10.7.2026	Dear, We are pleased to forward the name of Prof. dr. Neritan Ceka, Chair of the Archaeology Commission at the Academy of Sciences of Albania (cc), as the nominated representative.	E plotë	Nuk aplikohet
9.	30.6.2026	Kërkesë për informacion lidhur me konferencën shkencore ndërkombëtare “Enciklopedizmi dhe bota shqiptare”,	10.7.2026	Përshëndetje, Lidhur me kërkesën tuaj, për pajisje “...me certifikatën e Pjesëmarrjes në këtë konferencë, ose një Vërtetim Zyrtar Pjesëmarrjeje në konferencën shkencore ndërkombëtare “Enciklopedizmi dhe bota shqiptare”, Ju sqarojmë se dokumenti zyrtar për pjesëmarrjen në këtë konferencë lëshohet vetëm për pjesëmarrësit/kumtues të cilët janë regjistruar sipas rregullave në thirrjen publike https://akad.gov.al/wp-content/uploads/2026/03/Thirrje-per-pjesemarrje-ne-Konferencen-Shkencore-Nderkombetare-Enciklopedizmi-dhe-bota-shqiptare_compressed.pdf . Ju inkurajojmë që të merrni pjesë si kumtuese në konferencat e ardhshme që organizon ASHSH, sipas thirrjeve publike.	E plotë	Nuk aplikohet
10.	14.7.2026	Kërkesë për informacion	14.7.2026	infohistoria@akad.gov.al	E plotë	Nuk aplikohet
11.	13.8.2026	Kërkesë për informacion	13.8.2026	Përshëndetje, Përmbledhja me aktet e konferencës në fjalë nuk n’a është dorëzuar ende në sektor nga ana e përgatitësve, pra personave përgjegjës që ka ngarkuar komiteti që ka organizuar konferencën e përbashkët me ASHAK-un. Në një moment të dytë do ju njoftojmë për ecurinë e procesit.	E plotë	Nuk aplikohet

12.	31.7.2026	Kërkesë për informacion	31.7.2026	1. Cili është statusi aktual i monumentit arkeologjik të zbuluar në fshatin Strikçan, Bashkia Bulqizë, pas përfundimit të ekspeditës së parë kërkimore të zhvilluar gjatë vitit 2025? Nëse pyetja i referohet nëse monumenti gëzon një status si monument kulture i një kategorie të veçantë përgjigjja është jo, deri në këtë momente nuk është shpallur monument kulture. Ju informojmë që institucioni përgjegjës për shpalljen e statusve të veçantë është Ministria përgjegjëse e kulturës. Instituti i arkeologjisë asiston me përgatitjen e dosjes me informacionet e nevojshme mbi monumentin dhe ofron asistencën dhe ekspertizën e tij nëpërmjet arkeologove. Megjithatë edhe pse nuk gëzon akoma një status të veçantë Ligji për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë automatikisht e klasifikon në pasuri kulturore dhe pronë të shtetit shqiptar. Pasuritë kulturore, sitet arkeologjike dhe objektet që janë me origjinë nga nëntoka dhe hapësira ujore kombëtare e Republikës së Shqipërisë përbëjnë pronë shtetërore publike. Shteti është pronar i këtyre pasurive pavarësisht nëse janë nën tokë apo nën ujëra, nga mënyra e gjetjes së tyre apo personit që i ka gjetur dhe mbrohen me ligj. 2. Për çfarë arsye monumenti arkeologjik është mbuluar sërish pas përfundimit të ndërhyrjeve të para kërkimore dhe cilat masa konkrete janë marrë për garantimin e ruajtjes, konservimit dhe mbrojtjes së tij nga dëmtimet e	E plotë	Nuk aplikohet
-----	-----------	-------------------------	-----------	--	---------	---------------

				mundshme? Mbulimi i strukturave arkeologjike është një procedurë standarte që ndiqet nga të gjithë arkeologët brenda dhe jashtë vendit. Procesi i rimbulimit (backfill) kryhet për arsye konservimi paraprak në mënyrë që të mos depërtoj lagështia apo të dëmtohet fizikisht monumenti nga aktiviteti njerëzor apo kushtet klimaterike. Po ashtu rimbulimi kryhet kryesisht në sitet apo monumentet që nuk kanë ende një status mbrojtjeje të veçantë si dhe duke marrë parasysh që procesi i restaurimit dhe vizitueshmërisë merr një kohë të gjatë studimi dhe projektimi kështu që nuk mund të lihet i ekspozuar deri në miratimin dhe implementimin e këtyre fazave. Ju informojmë që mbulimi është realizuar sipas standarteve duke vendosur si fillim një shtresë me material gjeotekstili dhe më pas është hedhur dheu i gjermuar nga i njëjti sektor i gjermimit. Masa konkrete që janë marrë nga ekipi i arkeologëve që drejtojnë projektin janë rimbulimi (backfill), mbrojtja me shtresën e gjeotekstilit si dhe rivendosja në vendin përkatës të një prej elementëve strukturor-arkitekturor që u zbulua i zhvendosur nga konteksi origjinal si pasojë e gërmimeve ilegale. 3. A janë përfunduar procedurat për përfshirjen e këtij monumenti në listën e pasurive kulturore të mbrojtura nga shteti? Nëse po, lutemi të bëhet me dije data e vendimmarrjes, institucioni përgjegjës dhe statusi aktual i mbrojtjes së këtij siti.		
--	--	--	--	--	--	--

			Për sa më sipër, ju informojmë që Instituti I Arkeologjisë nuk është institucioni përgjegjës për shpalljen e monumenteve pasuri kulturore. 4. A ka përfunduar procesi i dokumentimit shkencor të zbulimit arkeologjik, përfshirë analizimin e mbishkrimeve, materialeve funerare, tekstileve me fije ari, objekteve të tjera të zbuluara dhe elementeve të strukturës monumentale? Nëse po, a janë publikuar ose planifikuar publikime shkencore mbi këto rezultate? Procesi i dokumentimit shkencor të gjetjeve përfshirë analizën e mbishkrimeve, materialeve funerare, tekstileve dhe elementeve të tjera strukturore të zbuluara në monument është aktualisht në fazën e studimit të thelluar që përfshin analiza arkeometrike, antropologjike, restaurime etj. Procesi i botimit kërkon kohë për të garantuar saktësinë shkencore dhe nuk mund të përfshijë vetëm rezultatet e një viti për të dhënë një analizë shkencore gjithëpërfshirëse për sitin. Drejtuesit e projektit kanë planifikuar që, pas përfundimit të plotë të këtyre analizave, rezultatet do të bëhen publike. Publikimi do të realizohet përmes artikujve dhe akteve shkencore, në përputhje me standardet akademike dhe legjislacionin për të drejtat e autorit, i cili mbron të dhënat e pabotuara deri në momentin e publikimit. Deri më tani, drejtuesit e projektit kanë paraqitur rezultatet e tyre	
--	--	--	---	--

			në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të titulluar “ Viti arkeologjik 2025” i realizuar në muajin Mars të vitit 2026 pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. 5. Në deklaratimet publike pas zbulimit të monumentit është bërë e ditur se projekti “Kërkime arkeologjike në luginën e Bulqizës” ishte konceptuar si një projekt shumëvjeçar, me kohëzgjatje të parashikuar rreth pesë vite. A vijon aktualisht ky projekt dhe cilat janë fazat konkrete të planifikuara për vitin 2026? Po projekti është aktiv dhe do të realizohet një ekspeditë arkeologjike në terren edhe në vitin 2026. Do të realizohen vëzhgime arkeologjike, sondazhe dhe gërmime. 6. A është planifikuar zhvillimi i një ekspedite të re arkeologjike në zonën e Strikçanit gjatë vitit 2026? Nëse po, lutemi të bëhet me dije periudha e parashikuar e fillimit të punimeve, kohëzgjatja dhe objektivat kryesore të kësaj ekspedite. Po është planifikuar një ekspeditë arkeologjike në zonën e Strikçanit gjatë vitit 2026. Momentalisht, jemi në fazën e përgatitjes së dosjes për aplikimin e marrjes së lejes nga Ministria përgjegjëse ndaj nuk mund të themi me siguri një periudhë të saktë të fillimit të punimeve pasi varet nga proceset administrative. Gjithashtu, për arsye të garantimit të sigurisë fizike të sitit nga ndërhyrjet e	
--	--	--	---	--

			paligjshme, datat e sakta të ekspeditave mbahen konfidenciale deri në nisjen e punimeve. Për sa i përket objektivave ato mbeten të njëjta për gjithë fazat e zbatimit të projektit shkencor që kryesisht fokusohen në zbulimin e potencialit arkeologjik nëpërmjet hulumtimeve sipërfaqësore , sondazheve dhe gërmimeve arkeologjike në mënyrë që tu jepen përgjigje pyetjeve shkencore që arkeologët kanë për periudhat specifike historike jo vetëm për zonën e Strikçanit por për të gjithë Luginën e Bulqizës, një zonë e cila deri më tani ka qenë fare pak e studiuar. 7. Në rast se nuk është planifikuar një ndërhyrje e re kërkimore në terren gjatë vitit 2026, cilat janë arsyet konkrete që kanë ndikuar në ndërprerjen ose shtyrjen e punimeve pas zbulimit të këtij monamenti? Sic e përmendëm më sipër, projekti do të zbatohet dhe në vitin 2026. 8. A ka pasur pengesa të natyrës financiare, administrative, teknike apo institucionale që kanë ndikuar në vijimësinë e projektit arkeologjik në luginën e Bulqizës? Sipas të dhënave që kemi nga arkeologët, problemi kryesor ka të bëjë me ndërhyrjet ilegale të gërmuesve klandestin të cilët kanë dëmtuar shtresat dhe monumetet arkeologjike në këtë lokalitet dhe rreziku për dëmtimin e mëtejshëm vazhdon të jetë egzistent në mungesë të një rrethimi dhe mbrojtje të zonës nëpërmejt survejimit apo ruajtjes fizike.		
--	--	--	---	--	--

			9. Cila është sipërfaqja totale e zonës që është parashikuar të hulumtohet në kuadër të projektit shumëvjeçar dhe sa pjesë e kësaj sipërfaqeje është eksploruar gjatë fazës së parë të kërkimeve? Për sa i përket pjesës së parë të pyetjes, ju informojmë që projekti ka në fokus të tij zonën e Luginës së Bulqizës e cila përfshin Bashkinë e Bulqizës ,qytetin dhe fshatrat e tij dhe do të kryhen ndërhyrje vetëm në zonat që kanë interes shkencor për arkeologët. Gjatë fazës së parë të kërkimeve në vitin 2025, sipërfaqja e eksploruar me gërmim ka qenë rreptësisht e përqendruar dhe e kufizuar në disa pika në fshatin Strikçan të Bulqizës me karakter përnjohës të potencialit arkeologjik. Kjo sipërfaqe përbën vetëm një fraksion të vogël të zonës tërësore në studim të projektit shumëvjeçar. Ju bëjmë me dije që hulumtimi i një sipërfaqeje të madhe kërkon një periudhë të gjatë kohore dhe burime të shumta njerëzore sidomos në rastet e terreneve malore dhe të pyllëzuara. 10. Gjatë fazës së parë të kërkimeve në zonën pranë varrit monumental, a janë identifikuar struktura të tjera arkeologjike, elemente ndërtimore apo gjurmë të tjera që kërkojnë vijim të hetimit shkencor? Lidhur me pyetjen nëse janë identifikuar struktura të tjera arkeologjike, elemente ndërtimore apo gjurmë pranë varrit monumental, ju bëjmë me dije se çdo e	
--	--	--	---	--

			dhënë e përftuar nga vëzhgimet sipërfaqësore në terren apo nga analizat e modeleve digjitale të relievit ka karakter thellësisht paraprak. Këto të dhëna përfaqësojnë rezultate shkencore të paverifikuara plotësisht dhe, në mbështetje të legjislacionit për të drejtat e autorit (Ligji nr. 35/2016), mbrohen si pronësi intelektuale dhe proces kërkimor i pashpalosur. Bërja publike e anomalive apo e strukturave të mundshme të pagërmuara, përveçse cënon të drejtën e botimit të parë shkencor të studiuesve, përbën një rrezik tejet të lartë për sigurinë fizike të zonës, duke ekspozuar sitin ndaj ndërhyrjeve të paligjshme dhe dëmtimeve të mundshme. Për këtë arsye, informacioni përfundimtar dhe i saktë mbi kontekstin e gjerë të sitit do të bëhet i njohur vetëm pasi këto gjurmë (nëse ekzistojnë) të jenë hetuar shkencërisht, të jenë dokumentuar plotësisht dhe të jenë botuar në aktet zyrtare akademike. 11. Cilat kanë qenë masat e ndërmarra nga Instituti i Arkeologjisë dhe Akademia e Shkencave pas zbulimit të monumentit për garantimin e mbrojtjes afatgjatë të këtij siti arkeologjik? Sic dhe e shpjeguar në Pyetjen nr.2 të listës suaj, ekipi i projektit ka realizuar konservimin paraprak dhe rimbullimin e gërmimit. Po ashtu dokumentacioni shkencor që hartohet nga arkeologët përgjegjës të projektit do të shërbejë për		
--	--	--	---	--	--

			plotësimin e dosjes për mbrojtjen ligjore të monumentit. Ju bëjmë me dije që mbrojtja afatgjatë e një siti arkeologjik nuk është kompetencë e Institutit të Arkeologjisë dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. 12. A ka një plan të hartuar për menaxhimin dhe zhvillimin e këtij siti arkeologjik pas përfundimit të fazës së kërkimeve shkencore, me qëllim kthimin e tij në një pikë me interes kulturor dhe turistik? Hartimi i një plani përfundimtar për menaxhimin dhe zhvillimin turistik të sitit arkeologjik të Strikçanit mund të jetë një synim i projektit pas përfundimit të aktivitetit shkencor. Në këtë fazë tërësisht embrionale për sa i përket njohjes të sitit në fjalë është tërësisht e pamundur të hartohet një plan menaxhimi. Po ashtu hartimi i një plani menaxhimi apo zhvillimi të një siti arkeologjik varet tërësisht nga bashkëpunimi ndërinstitutional por theksojmë që Instituti i Arkeologjisë është gjithmonë i gatshëm të asistojë me ekspertizën e tij institucionet shtetërore. Megjithatë, aktualisht nuk ka një plan të miratuar përfundimtar për këtë qëllim. Sipas praktikave dhe standardeve kombëtare e ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore, një plan i mirëfilltë menaxhimi dhe kthimi i një siti në një pikë vizitueshme mund të hartohet vetëm pasi të jenë përmbushur disa kushte thelbësore: • Përfundimi i plotë i kërkimeve		
--	--	--	--	--	--

				shkencore dhe përcaktimi i shtrirjes së saktë të potencialit arkeologjik. • Mbyllja e procesit të konservimit përfundimtar të strukturave dhe marrja e statusit të plotë të mbrojtjes ligjore. 13. A ka pasur komunikime ose bashkëpunim institucional me Ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe Bashkinë Bulqizë për ruajtjen, promovimin e këtij zbulimi? Nga të dhënat që kemi nga drejtuesit e projektit Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve si dhe Bashkia Bulqizë kanë shprehur gatishmërinë e tyre për ruajtjen dhe promovimin e këtij zbulimi. Bashkia Bulqizë ka qenë po ashtu e gatshme për tu ardhur në ndihmë arkeologëve gjatë zbatimit të projektit në vitin 2025, si në aspektin logjistik por dhe të ruajtjes të vendgjetjes në momentin e gërmimit duke vënë në dispozicion funksionarë të Policisë Bashkiake. 14. A është diskutuar mundësia që materialet dhe objektet e zbuluara në zonën e Strikçanit të ekspozohen në Bulqizë, përmes krijimit të një hapësire muzeale, qendre interpretimi apo një strukture		
--	--	--	--	--	--	--

				tjetër të dedikuar trashëgimisë arkeologjike lokale? Mundësia e ekspozimit të gjetjeve arkeologjike në një hapësirë muzeale ose qendër interpretimi në Bulqizë është një ide thellësisht e mirëpritur dhe e mbështetur në parim nga Instituti i Arkeologjisë, pasi i shton vlerë trashëgimisë kulturore lokale. Megjithatë, duhet theksuar se ngritja e strukturave të tilla të dedikuara është një nismë që kërkon angazhimin e drejtpërdrejtë administrativ, infrastrukturor dhe financiar të pushtetit vendor (Bashkisë Bulqizë) dhe miratimin nga Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Për momentin, të gjitha materialet dhe objektet e zbuluara gjatë ekspeditës i nënshtrohen procedurave strikte ligjore dhe shkencore. Ato po kalojnë proceset e detyrueshme laboratorike të pastrimit, konservimit, restaurimit, si dhe studimit e publikimit shkencor nga specialistët e Institutit të Arkeologjisë. Kjo është një fazë themelore që duhet të përfundojë plotësisht përpara se çdo objekt të bëhet i gatshëm për t'u ekspozuar për publikun. Në momentin që Bashkia Bulqizë apo institucionet e tjera kompetente do të iniciojnë dhe miratojnë një projekt konkret për krijimin e një hapësire	
--	--	--	--	--	--

			ekspozimi lokal, Instituti i Arkeologjisë është i hapur dhe i gatshëm të ofrojë të gjithë ekspertizën dhe mbështetjen e nevojshme shkencore për jetësimin e këtij projekti. 15. A ekziston një afat i përcaktuar se kur do të rikthehen kërkimet në terren në zonën e Strikçanit dhe kur publiku mund të ketë një informacion më të plotë mbi rezultatet e kësaj ekspedite? Aktualisht nuk ekziston një afat i përcaktuar dhe fiks se kur do të rinisin kërkimet fizike në terren në zonën e Strikçanit, por është planifikuar dhe miratuar nga Instituti I Arkeologjisë vazhdimi i ekspeditës edhe në vitin 2026. Përcaktimi i një kalendari të saktë mbetet i kushtëzuar nga përmbyllja e procedurave administrative dhe financiare, si dhe nga planifikimi i angazhimeve akademike të stafit kërkimor. Kjo qasje siguron kohën e nevojshme për përpunimin e të dhënave, ndërkohë që theksojmë sërish se kalendari i saktë i ekspeditave mbahet konfidencial për të garantuar sigurinë e sitit arkeologjik. Për sa i përket kohës se kur publiku do të ketë një informacion më të plotë, ju sqarojmë se procesi i interpretimit	
--	--	--	--	--

			arkeologjik kërkon kohë dhe saktësi maksimale. Informacioni i plotë, i verifikuar shkencërisht mbi analizat strukture, epigrafike dhe materiale të monumentit, do të bëhet i disponueshëm për publikun vetëm pasi arkeologët të kenë përfunduar të gjitha studimet dhe t'i ketë botuar ato përmes kanaleve zyrtare dhe akteve shkencore akademike. Deri në atë moment, rezultatet paraprake janë të mbrojtura ligjërisht sipas Ligjit nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to". Po ashtu duhet të përmendim faktin që rasti i zbulimit të varrit monumental në Strikçan të Bulqizës është një nga rastet e vecanta ku drejtuesit e projektit arkeologjik vendosën të publikojnë menjëherë në media kombëtare dhe ndërkombëtare rezultatet paraprake të gërmimit duke qenë akoma në proces gërmimi por dhe pas tij. Sigurisht me qëllim informimin e publikut mbi trashëgiminë kulturore të Bulqizës dhe sensibilizimin e komunitetit për qasjen që duhet të kenë përkundrejt kësaj pasurie. Gjithashtu duhet marrë parasysh që sësht përmbyshur akoma plotësisht një vit i plotë nga momenti i zbulimit i monumentit si dhe arkeologët drejtues të projektit drejtojnë ose bashkëpunojnë dhe në shumë projekte të tjera arkeologjike të cilat kërkojnë angazhimin e tyre kohor	
--	--	--	--	--

				dhe shkencor. Po ashtu, të dhënat janë paraprake mbi potencialin e zonës kështu që për të ndërrmarë hapa konkret më gjithëpërfshirës si rijetëzimi, vizitueshmëria, publikimi, restaurimi etj është e nevojshme studimi disavjeçar dhe multi-disiplinor i gjetjeve dhe siteve të mundshme arkeologjike në zonën e studimit.		
13.	26.8.2026	Kërkesë për informacion lidhur me identifikimin e vlerësimit e disa monedhave	1.9.2026	Përsëhendetje, Në vijim të kërkesës suaj lidhur me identifikimin, vlerësimit dhe procedurat përkatëse për monedhat e përmendura në komunikimin tuaj, ju bëjmë me dije se kjo kërkesë nuk përfshihet në kompetencat e Institutit të Arkeologjisë. Ju lutemi t'i drejtoheni Ministrisë së Kulturës, si institucioni kompetent, e cila, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar, është përgjegjëse për vlerësimit, verifikimin, regjistrimin dhe pajisjen me certifikatë të objekteve, si dhe për orientimin lidhur me procedurat që duhet të ndiqen për shqyrtimin e kërkesës suaj.	E plotë	Nuk aplikohet
14.	28.8.2026	Kërkesë për informacion / Inquiry Regarding Kadria, S., Merkuri, E., Shqipëria mes dy luftërave botërore: aspekte të politikës, të së drejtës dhe shoqërisë shqiptare në vitet	31.8.2026	Dear ..., With regard to your request, we hereby confirm that the book is available at our bookstore. For any further information and assistance, please find below the phone number of, Academic Book Sales Specialist at our institution, who will be pleased to assist you further with your	E plotë	Nuk aplikohet

		1925-1939		request.		
15.	30.8.2026	Kërkesë informacioni për diplomë	31.8.2026	Përsëndetje, Ju informojmë se për të dhënat që kërkon, të mund t'i drejtoheni Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, pasi Parku Arkeologjik i Apollonisë është në administrim të këtij institucioni. Në vijim gjeni adresën e tyre elektronike në faqen web https://mtks.gov.al/kontakt/. Suksese në studimet tuaja.	E plotë	Nuk aplikohet